

Raport Vjetor 2023

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Adresa: Bulevardi “Zhan
D’Ark”, Prona nr.33, ish Shtëpia e
Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri
Email: info@dppi.gov.al
Web: www.dppi.gov.al
Tel: +355 (0) 4227167

Tabela e Lëndës

PRONËSIA INDUSTRIALE	6
FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PRONËSISË INDUSTRIALE	7
QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE.....	9
STATUSI	10
MISONI.....	10
FOKUSI	10
OBJEKTIVAT	10
TË DHËNA STATISTIKORE PËR OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE.....	11
Aplikime për Regjistrim Marke.....	11
Aplikime Për Regjistrim Ndërkombëtar të Markës Kombëtare	13
Regjistrime të Markave Kombëtare dhe Ndërkombëtare	13
Regjistrime të Markave Kombëtare	14
Kërkesat për Ripërtëritje të Markave.....	15
Renditja sipas disa klasave të klasifikimit të Nicës së aplikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.	15
Numri i Aplikimeve Sipas Vendit të Origjinës së Aplikantit.....	16
Disenjt Industrialë në Republikën e Shqipërisë.....	17
Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës.....	18
PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT	19
APLIKIME PËR PATENTA.....	19
Aplikime për Patenta Kombëtare.....	20
Aplikime për Patenta Ndër Vite.....	20
APLIKIME PËR MODELE PËRDORIMI	21

STATISTIKA TË EKZAMINIMIT TË PATENTAVE.....	19
Sektori i Pritjes dhe Informacionit	22
VEPRIMTARIA E KOORDINIMIT DHE E PROMOVIMIT TË AKTIVITETEVE NDËRGJEGJËSUESE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, ME TË GJITHË GRUPET E INTERESIT.....	25
AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT 2023	26
18 Janar 2023 - Webinar online “IPO Green Webinar with IP Australia”	26
1 Mars 2023 - Webinar-i i tretë i serive "IPO Green", për periudhën e pranverë 2023	26
16 Mars 2023 - Webinar IPO Green, me Institutin Kombëtar për Mbrojtjen e Konkurrencës së Lirë dhe Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (INDECOPI) Peru.....	26
20 Mars 2023 - Workshop për prokurorë dhe gjyqtarë.....	27
5-6 Prill 2023 - Workshop me temë "TAIEX Workshop on Building Bridges Between Academia and Industry in the Field of Intellectual Property"	27
26 Prill 2023 Konferenca me temë "Pronësia Intelektuale dhe Gratë, Inovacioni dhe Kreativiteti, në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale.....	27
30 Qershor 2023 - Mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 dhe për arritjen e objektivave për 6- mujorin e dytë.....	28
21 nëntor 2023 - Takim me operatorët turistikë të qytetit të Tiranës, në kuadër të projektit shqiptaro-zviceran (ALSIP)	28
7 Dhjetor 2023 - Webinar-i Rajonal mbi Mbrojtjen e Markës Tregtare jashtë vendit.	29
8 Dhjetor 2023 - Përfaqësimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale në 30 vjetorin e themelimit të “Enti Shtetëror për Pronësi Industriale” (ESHPI), i Maqedonisë së Veriut.....	29
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE WIPO/ EPO/ EUIPO.....	30
Forumi vjetor i Gjykatësve të Pronësisë Intelektuale të WIPO-s	30
MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT.....	32
Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve	36
Ndërgjegjësimi me në fokus BIZNESIN	36
Qendra e Trajnimeve	38
INICIATIVA LIGJORE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE	40
SEKTORI JURIDIK.....	40
DHOMA PËR SHFUQIZIM/ZHVLERËSIM.....	43
BORDI I AELIT	43
FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE	45
TË ARDHURAT	46
SHPENZIMET	49
PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN	51
STRATEGJIA E RE KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025	53
Mirënjohje.....	54

SHKURTIME:

BE Bashkimi European

DPPI Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

EPO European Patents Office Euiipo European Union Intellectual Property Office

INTA Shoqata ndërkombëtare e markave

OBPI Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

PI Pronësia Intelektuale

PKIE Planit Kombëtar për Integrimin European

QTT Qendrat e Transferimit të Teknologjisë

ZBEPI Zyra e Bashkimit European për Pronësinë Intelektuale

ZEP Zyra Europiane e Patentave

WIPO Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

HYRJE

Ky raport, tregon dhe reflekton zbatimin, ndikimin, perspektivën e standardeve si dhe efencën e stafit si specialistë profesionistë në fushën e Pronësisë Industriale. Raporti bazohet në të dhënat stastikore të drejtorive dhe sektorëve përbërës të DPPI-së mbi punën e kryer gjatë vitit 2023.

Raporti Vjetor i DPPI-së, shërben si një urë komunikimi, për të përhapur në mënyrë transparente njohuri të ndryshme rreth drejtorisë dhe punës së saj voluminoze. Gjithashtu, ky raport i shërben zbatimit aktual të ligjit për pronësinë industriale dhe për rritjen e ndërgjegjësisë mbi rëndësinë e kësaj të fundit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, përcakton në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat afatshkurtra dhe afatmesme, për të përmbushur në mënyrë të plotë vizionin e saj.

Objektivi kryesor i DPPI-së është të ofrojë mbrojtjen e pronësisë industriale në të njëjtin nivel me vendet europiane. Detyra e saj është të rrisë cilësinë e ekzaminimit të objekteve të Pronësisë Industriale si dhe të ndërgjegjësojë publikun e gjerë mbi rëndësinë e të drejtave që përftohen nga regjistrimi i tyre. Të mirat dhe përfitimet që burojnë nga mbrojtja e objekteve të PI-së janë faktorë nxitës për zhvillimin ekonomik të bizneseve, si dhe ndihmojnë në vendosjen e konkurrencës së ndershme në tregun ku ata operojnë, duke i kthyer në kontribues të vyer në rritjen e ekonomisë së vendit.

Është kjo arsyeja themelore përse është tejet e rëndësishme të ngrihet një sistem kombëtar funksional dhe i besueshëm i Pronësisë Industriale, i cili krijon, rrjedhimisht, një mjedis stimulues, ku bizneset, industritë dhe individët ndjehen të sigurtë, se puna dhe investimi i tyre janë të mbrojtura nga vjedhja, falsifikimi dhe keqpërdorimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përbën një hallkë kyçe të këtij sistemi, pasi është i vetmi insitucion politkbërës dhe përfaqësues i Shqipërisë pranë organizatave botërore, për çështjet që i takojnë pronsësisë intelektuale.

Duke patur parasysh se çfarë u tha më lartë, si dhe me besimin dhe vullnetin e plotë, që zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë është në rrugën e duhur, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me vendosmëri dhe përkushtim, do të vazhdojë të çojë përpara zhvillimin e bashkëpunimeve dhe negociatave me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në këtë fushë, për të përmbushur jo vetëm misionin e saj, por edhe për të nxitur zhvillimin e inovacionit në vend.

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PRONËSISË INDUSTRIALE

I nderuar lexues,



Përmes publikimit të raportit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, kam kënaqësinë të ndaj me ju punën dhe veprimtarinë e kryer prej këtij institucioni gjatë vitit 2023.

Ky raport është një mjet i rëndësishëm transparence dhe llogaridhënieje, në të cilin drejtoria jonë synon të paraqesë rezultatet dhe punën e kryer përgjatë harkut kohor të një viti kalendarik.

Viti 2023 është mbyllur me rezultate të kënaqshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Shifrat e këtij viti janë pasqyrim i punës së palodhur të stafit të DPPI-së, por edhe i të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e Pronësisë Industriale.

Më lejoni të ndaj me ju disa nga arritjet kryesore të institucionit tonë. Që prej datës 31 korrik 2023, DPPI-ja i ofron shërbimet vetëm në platformën online. Ndërtimi dhe vënia në punë e sistemit të ri të ekzaminimit të aplikimeve në lidhje me objektet e PI-së, e shkurtoi ndjeshëm kohën e ofrimit të shërbimeve, eleminoi kohën e protokollimit dhe marrjes në dorëzim të akteve administrative pas postimit të tyre nga DPPI-ja dhe reduktoi masivisht gabimet e shfaqura gjatë procesit të skanimit, indeksimit dhe delegimit të dokumentacionit të depozituar. Tashmë të gjitha aktet administrative të hartuara janë të digjitalizuara në sistemin SAPI dhe ekzaminuesit mund t'i aksesojnë ato në kohë reale.

Gjatë vitit 2023, DPPI-ja iu nënshtrua procesit të standartizimit të shërbimeve të ofruara, sipas ISO 9001.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme e vitit që lamë pas, ishte kremtimi i 30-vjetorit të themelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në kuadër të të cilit u mbajt në Tiranë konferenca ndërkombëtare 2-ditore me temë: “Women in Tradition, Innovation, Creativity and Entrepreneurship”. Ky event u nderua, si asnjëherë më parë, nga krerët më të lartë të tri organizatave ndërkombëtare të pronësisë intelektuale, si WIPO, EPO dhe EUIPO. Prania e tyre ishte një vlerësim i drejtëpërdrejtë për punën dhe arritjet e drejtorisë përgjatë vitit 2023.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore, me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE-së, vazhdon të qëndrojë në fokusin e veprimtarisë së DPPI-së.

Janë hartuar dhe përcjellë për miratim 2 projektligje për patentat dhe markat tregëtare, si dhe, brenda vitit 2024, pritet të miratohen edhe dy projektligjet për aderimin e Shqipërisë në Traktatin e Najrobit dhe atij të Singaporit. Punë e rëndësishme është bërë dhe vijon të bëhet në drejtim të ndërgjegjësisë dhe edukimit të publikut e palëve të interesuara, në lidhje me rëndësinë e regjistrimit të objekteve të PI-së dhe përfitimet që sjell gëzimi i të drejtave mbi to në zhvillimin e biznesit.

Në përfundim të fjalës sime, më lejoni të shpreh falënderimet e mia për të gjitha institucionet partnere, institucionet në nivel kombëtar të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale dhe anëtarët e grupit ndër-institucional të punës së Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”, përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë.


Mirënjohje të thellë, shpreh për Organizatat Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale, të cilat kanë dhënë një kontribut të vyer për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Për anëtarët e palodhur të stafit tim, puna dhe përkushtimi juaj janë shtylla mbajtëse e suksesit të vitit që lamë pas. Faleminderit për gjithçka që bëni!

Jam vërtet mirënjohëse që kam një ekip kaq të talentuar dhe të përkushtuar.

PËRZEMËRSISHT

MARIA SOLIS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR



QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është institucion publik jo-buxhetor me seli në Tiranë, i cili regjistron, administron dhe promovon objektet e Pronësisë Industriale dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë. Gjithashtu, DPPI-ja luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale tek palët e interesuara, aktorët e përfshirë në sistem si dhe tek universitetet a institucionet arsimore në mbarë vendin.

STATUSI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së.

DPPI-ja është institucioni i vetëm përmes së cilit, shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të këtyre të drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre.

Gjithashtu, DPPI-ja kryen rolin e koordinatorit të Kapitullit 7, “Pronësia Intelektuale”, për të cilin raporton pranë Komitetit të Stabilizim Asociimit dhe Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës, si dhe pranë Delegacionit të Bashkimit European, mbi ecurinë dhe aktivitetin e kryer, në përmbushje të detyrimeve që i ngarkohen nga dokumentet strategjike.

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale është të forcojë mbrojtjen e Pronësisë Industriale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet njohjes, regjistrimit dhe promovimit të të drejtave mbi objektet e Pronësisë Intelektuale, për të garantuar të një njëjin nivel mbrojtjeje me atë të vendeve të Bashkimit European.

FOKUSI

Në fokusin e DPPI-së është përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë industriale, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit, përmes stimulimit të punës kërkimore, veçanërisht asaj të kompanive, universiteteve dhe individëve shqiptar, për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit.

OBJEKTIVAT

- Përsosja e menaxhimit dhe koordinimit të brendshëm dhe më gjerë, për të përmirësuar mbrojtjen dhe zbatimin e Pronësinë Intelektuale në mbarë botën;
- Arritja e një organizimi të shkëlqyer për forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Tejkalimi me sukses i sfidave për implementimin e synimeve, objektivave dhe iniciativave të ndërrmarra në “Strategjinë e Re Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025”.

TË DHËNA STATISTIKORE PËR OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtoria e Ekzaminimit, si një ndër strukturat më të rëndësishme të DPPI-së, ka si detyrë funksionale regjistrimin e objekteve të PI-së, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve.


Drejtoria e Ekzaminimit, ka në përbërje të saj 17 punonjës, të cilët janë të strukturuar në 3 sektorë:

1. Sektori i Markave, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë;
2. Sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit;
3. Sektori i Pritjes dhe Informacionit.

Aplikime për Regjistrim Marke


Përgjatë vitit 2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë paraqitur për regjistrim marke në total 1311 aplikime, në krahasim me 1165 aplikime të vitit 2022.

Nëse krahasojmë vitin 2022 me vitin 2023, grafiku tregon, se numri i aplikimeve kombëtare dhe numri i aplikimeve ndërkombëtare ka pësuar rritje.



Në totalin prej 1311 aplikimesh kombëtare për regjistrim marke, aplikimet nga subjektet shqiptare, në vitin 2023, arritën në 955. Në numrin total të aplikimeve në % për vitin 2023, aplikimet ndërkombëtare zënë 68%, kurse

aplikimet kombëtare zënë 32%, nga të cilat, aplikime kombëtare nga aplikantë të huaj zënë rreth 27.8% dhe aplikimet nga aplikantë vendës zënë 72.2%.



Aplikime ndërkombëtare (2688)


Aplikime kombëtare nga subjekte vendase (955)

Aplikime kombëtare nga subjekte të huaja(356)

Gjatë vitit 2023, janë depozituar 39 (tridhejtë e nëntë) kërkesa nga subjekte shqiptare që kanë kërkuar shtrirje ndërkombëtare të aplikimeve të tyre, nëpërmjet marrëveshjes së Madridit.

Kjo tregon se këto subjekte eksportuese janë ndërgjegjësuar, se hapi i parë përpara se të eksportojnë produktet e tyre është regjistrimi ndërkombëtar i aplikimit nëpërmjet marrëveshjes së Madridit, ku shteti shqiptar është palë dhe, se ky regjistrim kryhet nëpërmjet DPPI-së.

Aplikime për Regjistrim Ndërkombëtar të Markës Kombëtare



Regjistrime të Markave Kombëtare dhe Ndërkombëtare


Gjatë vitit 2023, janë lëshuar në total 1087 (njëmijë e tetëdhjetë e shtatë) certifikata regjistrimi marke kombëtare, ndërsa nga Marrëveshja e Madridit, për të njëjtin vit, janë regjistruar 2954 (dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) aplikime ndërkombëtare.

Më poshtë do të gjeni të pasqyruar trendin nga viti 2017 deri në vitin 2023 për regjistrimet kombëtare dhe regjistrimet nga Marrëveshja e Madridit.

Regjistrime të Markave Kombëtare




Siç pasqyrohet edhe në tabelën e mëposhtme, vihet re një trend rritës i regjistrimit të markave nga Marrëveshja e Madridit, pra rreth 32% regjistrime më shumë se gjatë vitit 2022.



Në vijim, është pasqyruar trendi i regjistrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare i markave nga viti 2020 deri në vitin 2023.

Garfik Krahasues Marka Kombëtare/Marka Ndërkombëtare




Kërkesat për Ripërtëritje të Markave

Renditja sipas disa klasave të klasifikimit të Nicës së aplikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.


Në tabelën më poshtë, vihet re se numri i markave kombëtare të ripërtëritja, për të cilat është lëshuar certifikata e ripërtëritjes gjatë vitit 2023 në krahasim me vitet 2021 dhe 2022, ka pësuar rritje. E shprehur në %, në krahasim me vitin 2022, rritja është afërsisht 9.1%, ndërsa krahasuar me vitin 2021, rritja është 10.5%.

Marka Kombëtare të Ripërtëritja




Në vitin 2023, në aplikimet për regjistrim marke, sipas klasave të klasifikimit të Nicës, numrin më të madh e zenë aplikimet për produktet që i takojnë klasës 35 (e cila përfshin marketingun dhe reklamat), ndjekur nga aplikimet që i takojnë mallrave të klasës 43 (produkte farmaceutike, sanitare dhe veterinare).

Gjithashtu, janë evidentuar aplikimet për produktet e klasës 5 (kryesisht shërbimet për sigurimin e ushqimit dhe pijeve, strehim të përkohshëm etj), mallrat e klasës 3 (produkte të pastrimit), shërbimet e klasës 41 (e cila përfshin edukimin, aktivitetet sportive dhe kulturore) dhe shërbimet e klasës 42, etj.




Numri i Aplikimeve Sipas Vendit të Origjinës së Aplikantit

Nëse vështrojmë numrin e aplikimeve kombëtare për regjistrim marke sipas vendit të origjinës së aplikantit, në vitin 2023, Shqipëria zë vendin e parë, e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina, Italia, Maqedonia, Turqia, Japonia, Zvicra, Gjermania etj., të cilat kanë numrin më të madh të aplikimeve kombëtare në Republikën e Shqipërisë.



Disenjt Industrialë në Republikën e Shqipërisë

Në Republikën e Shqipërisë, disenjt industrialë mbrohen nëpërmjet regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, e cila zbaton të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e tyre, si dhe nëpërmjet sistemit të Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të tyre. Për vitin 2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, janë depozituar 38 kërkesa kombëtare për regjistrim disenjoje industriale. Nëse do të bënim një ndarje sipas klasifikatorit ndërkombëtar të Locarnos, pjesën më të madhe të këtyre aplikimeve e zënë disenjt që përfshihen në klasën 25 dhe nënklasën 01 të këtij klasifikatori, me 18 aplikime, të cilat pasohen nga aplikimet që përfshihen në klasën 25 dhe nënklasën 02, me 4 aplikime.



Në grafikët e mësipërm është bërë një krahasim i viteve të fundit për sa i përket regjistrimit dhe ripërtëritjeve të disenjove industriale. Gjatë vitit 2023, lëshimi i certifikatave të regjistrimit dhe certifikatave për ripërtëritje të disenjove industriale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale ka pasur një tendencë në rritje. Më konkretisht, janë lëshuar 25 (njëzet e pesë) certifikata regjistrimi për disenjo industriale dhe 5 (pesë) certifikata ripërtëritje për disenjot industriale.

Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës

Shqipëria është sot ndër vendet e Europës Juglindore që ka arritur progres në lidhje me implementimin e legjislacionit dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.

Zhvillimet e viteve të fundit në fushën e legjislacionit dhe mbrojtjes së produkteve si treguesit gjeografikë/emërtimet e origjinës, kanë bërë që Shqipëria të radhitet denjësisht ndër vendet e Europës Juglindore me potencial për regjistrimin e tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i vetëm në Shqipëri, që merret me procedurat për mbrojtjen dhe regjistrimin e treguesve gjeografikë/emërtimeve të origjinës. Legjislacioni në fushën e PI-së është plotësisht i përafëruar me atë të vendeve të BE-së. Shqipëria ka aderuar në marrëveshjen e Lisbonës “për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”. Vendi ynë ka potencial të jashtëzakonshëm që produkte apo procese të tjera, të mund të regjistrohen si TGJ/EO në nivel kombëtar.

Regjistrimi i produkteve si tregues gjeografik dhe emërtim origjine ka marrë një rëndësi të veçantë në ditët e sotme. Produktet të cilat mbrohen si tregues gjeografik dhe emërtim origjine, pasi certifikohen u vendoset një logo, e cila i dallon ato nga produktet e tjera në tregun vendës.

Gjatë vitit 2023 në DPPI, janë depozituar 3 aplikime për regjistrim emërtim origjine.

Gjithashtu, gjatë po këtij viti, është lëshuar 1 certifikatë regjistrimi për emërtim origjine, konkretisht në lidhje me produktet e klasës 31 të klasifikimit të Nicës, “Qepë e fresket” nën emërtimin “Qepa e Drishtit”.

Nga marrëveshja e Lisbonës “për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”, për vitin 2023, janë depozituar 3 aplikime, nga të cilat 3 janë aplikime për regjistrim treguesi gjeografik dhe 0 aplikime për regjistrim emërtim origjine.

STATISTIKA TË EKZAMINIMIT TË PATENTAVE


PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT

Spektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit ka si detyrë funksionale regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale, siç janë patentat për shpikje dhe modelet e përdorimit, si dhe administrimin e regjistrave të këtyre objekteve.

Gjatë vitit 2023, Spektori i Patentave dhe i Modeleve të Përdorimit, ka marrë 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) aplikime për patenta, nga të cilat, 9 (nëntë) janë aplikime për patentë kombëtare nga shtetas shqiptarë dhe 658 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Europiane e Patentave, të cilat kërkojnë mbrojtje në Republikën e Shqipërisë.

APLIKIME PËR PATENTA

APLIKIME	2019	2020	2021	2022	2023
Aplikime për Patentë Kombëtare	5	12	23	20	9
Patenta nga Zyra Europiane e Patentave	908	885	923	601	658
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit	0	1	2	0	3
Aplikime për Certifikatë të Mbrojtjes Shtesë	0	1	3	4	4
TOTALI/ PATENTA	913	898	948	621	667




Aplikime për Patenta Kombëtare

Aplikimet kombëtare janë kryesisht të fushave:

- 4 patenta të fushës mekanike;
- 2 patenta të fushës mjekësore/farmaceutike;
- 1 patentë e fushës së teknologjisë së informacionit;
- 2 patenta të fushës së artikujve personalë/shtëpiakë (nevoja njerëzore).

Aplikime për Patenta ndër Vite

Grafiku i mëposhtëm tregon aplikimet për patenta të depozituara ndër vite.




APLIKIME PËR MODELE PËRDORIMI

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, janë depozituar 3 aplikime për regjistrim të modeleve të përdorimit, ndërsa për periudhën janar - dhjetor të vitit 2022, ka pasur 3 aplikime për model përdorimi.

Aplikime për Model Përdorimi

APLIKIME	2019	2020	2021	2022	2023
Aplikime për Model Përdorimi	1	2	3	3	3

Më poshtë është paraqitur në mënyrë grafike numri i aplikimeve për modelet e përdorimit gjatë viteve të fundit:



Sektori i Pritjes dhe i Informacionit

Gjatë vitit 2023, objektivat kryesorë të Sektorit të Pritjes dhe Informacionit, në kuadrin e Drejtorisë së Ekzaminimit të DPPI-së, kanë qenë:

1. Pjesëmarrja direkte në rritjen e cilësisë dhe në shkurtimin e afateve të ekzaminimit të kërkesave të depozituara lidhur me objektet e PI-së, nëpërmjet kontrollit periodik të detyrave të specialistëve të sektorit;
2. Pjesëmarrja në veprimtarinë ligjore të Sektorit të Pritjes dhe Informacionit dhe përmbushja e detyrave ligjore në afat;
3. Pjesëmarrja aktive në promovimin e PI-së, në mbarë Republikën e Shqipërisë;
4. Rritja e cilësisë së hartimit të buletinit të Pronësisë Industriale;
5. Përgatitja e statistikave, raporteve, dhe materialeve të tjera lidhur me veprimtarinë e Sektorit, si dhe pjesëmarrja aktive në procesin e hartimit të planeve strategjike të institucionit, përmirësimeve legjislative për objektet e PI-së.
6. Mirëmbajtja, administrimi dhe përpunimi i arkivit të objekteve të PI-së;
7. Ekzaminimi në afat dhe me cilësi i aplikimeve ndërkombëtare, lidhur me njohjen e të drejtave të objekteve të PI-së;
8. Dhënia e informacionit zyrtar për publikun, në kohë sa më të shkurtër, me etikë dhe profesionalizëm;

9. Kryerja në kohë e procedurave që kanë të bëjnë me funksione të veçanta, të cilat mund t'u ngarkohen punonjësve të Sektorit të Pritjes dhe Informacionit, për shembull si: anëtarë të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, anëtarë të Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim apo anëtarë të çdo organi tjetër dhe komisioni të ngritur nga DPPI-ja.


Detyrat më të rëndësishme të Sektorit të Pritjes dhe Informacionit janë:

1. Ekzaminimi i aplikimeve për regjistrimin ndërkombëtar të objekteve të PI-së;
2. Përgatitja e përgjigjeve për kërkesat për informacione të ndryshme që gjenerohen nga arkivi elektronik dhe ai shkresor i objekteve të PI-së;
3. Informimi verbal dhe me mjete elektronike i publikut në lidhje me procedurat e veprimeve që kryen Sektori i Ekzaminimit në lidhje me objektet e PI-së;
4. Administrimi, mirëmbajtja dhe përpunimi periodik, i vazhdueshëm i arkivit shkresor të objekteve të PI-së në DPPI, etj.

Sektori i Pritjes dhe Informacionit, për arritjen e qëllimit të zbatimit të objektivave të sipërpërmendur, ka realizuar ndër të tjera, shifrat si vijon:

- ✓ Ka pritur, procesuar, protokolluar, digjitalizuar dhe hedhur në sistem, si dhe pastaj përcjellë për ndjekje 20.406 dokumente si: aplikime për regjistrim, ripërtëritje të objekteve të PI-së, ndryshime në regjistër dhe dokumente plotësuese, nga të cilat të rëndësishme për t'u theksuar janë:
 - 667 aplikime për patenta, nga të cilat 9 janë patenta kombëtare, të cilat janë ekzaminuar për njohjen e datës së depozitimit;
 - 38 aplikime për regjistrimin e disenjove industriale, të cilat janë ekzaminuar për njohjen e datës së depozitimit;
- ✓ 1313 aplikime për regjistrimin e markave, të cilat janë ekzaminuar për njohjen e datës së depozitimit, 15 kërkesa për regjistrime ndërkombëtare të objekteve të PI-së;
- ✓ Ka lëshuar aktet administrative, si vijon:
 - 1311 Dëshmi Depozitimi;
 - 181 përgjigje kërkesave për hetime të objekteve të PI-së;
 - 16 përgjigje kërkesave për dublikata;
 - 10 përgjigje kërkesave për inspektime;
 - 162 përgjigje të kërkesave për ekstrakte regjistri të PI -së;

- 447 E-mail-e informuese për publikun.
- ✓ Ka publikuar:
 - 37 buletine të patentave;
 - 39 buletine të markave tregtare, disenjove industriale, emërtime origjine dhe tregues gjeografikë;
- ✓ Lidhur me punën për arkivin e objekteve të PI-së, janë realizuar, ndër të tjera:
 - 13.000 marrje në dorëzim/Sistemim/Transportim/Verifikim të dosjeve për përpunim;
 - 5510 plotësime indeksesh së dosjeve/nxjerrje e fletëve të regjistrit;
 - 6023 sistemim dosjesh, në kutitë përfundimtare për arkivin, etj.



VEPRIMTARIA E KOORDINIMIT DHE E PROMOVIMIT TË AKTIVITETEVE NDËRGJEGJËSUESE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, ME TË GJITHË GRUPET E INTERESIT

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës së DPPI-së, është një strukturë me rëndësi të veçantë për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të Pronësisë Industriale. Kjo drejtori, përbëhet nga dy sektorë, Sektori i Koordinimit, Raportimeve dhe Analizës (4 punonjës) dhe Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve (4 Punonjës).

Roli i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës është të promovojë në nivel kombëtar pronësinë industriale dhe të mbrojë subjektet e interseruara nga falsifikimi dhe kopjimi i mallrave e shërbimeve.

Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese mbi Pronësinë Industriale, si video; libra; broshura; artikuj për rrjetet sociale dhe faqen zyrtare të DPPI-së, etj.


Janë ndërmarrë bashkëpunime teknike në formën e marrëveshjeve dypalëshe me zyrat homologe rajonale dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale për ngritjen e Qendrave të Informacionit Teknik Shkencor, për bashkëpunime të mëtejshme.

Ndërkaq, DPPI-ja, vijon koordinimin e punës me organizatat ndërkombëtare WIPO, EPO dhe EUIPO, sipas marrëveshjeve teknike në fuqi. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve të suksesshme, është mundësuar ofrimi i shërbimeve të reja dhe është përfituar një asistencë teknike dhe profesionale e lartë, duke rritur ndjeshëm në këtë mënyrë, kapacitetet administrative dhe institucionale, si dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT 2023



18 JANAR 2023 - WEBINAR ONLINE “IPO GREEN WEBINAR WITH IP AUSTRALIA”



1 MARS, 2023 - WEBINAR-I I TRETË I SERIVE “IPO GREEN”, PËR PERIUDHËN PRANVERË 2023,

nga Zyra e Patentave të Izraelit (ILPO)
me temë: “Shqyrtimi i përshpejtuar i aplikimeve
për patentë, për të përfituar nga teknologjia e
gjelbër dhe zgjidhje të tjera të qëndrueshme”.

16 MARS, 2023 - WEBINAR IPO GREEN, ME INSTITUTIN KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS SË LIRË DHE MBROJTJEN E PRONËSISË INTELEKTUALE (INDECOPI) PERU.



20 MARS, 2023 - WORKSHOP PËR PROKURORË DHE GJYQTARË,
si dhe institucione ligjzbatuese në fushën e zbatimit të të drejtave
të pronësisë intelektuale, në kuadër të projektit shqiptaro- zviceran (ALSIP).



**5-6 PRILL, 2023 - WORKSHOP
ME TEMË “TAIEX WORKSHOP ON BUILDING BRIDGES
BETWEEN ACADEMIA AND INDUSTRY IN THE FIELD OF INTELLECTUAL PROPERTY”.**



**26 PRILL, 2023 KONFERENCA ME TEMË “PRONËSIA INTELEKTUALE DHE GRATË,
INOVACIONI DHE KREATIVITETI, NË KUADËR TË DITËS BOTËRORE
TË PRONËSISË INTELEKTUALE.**




**30 QERSHOR, 2023 - MBLEDHJA E GRUPIT
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR MONITORIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE
TË PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025
DHE PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE
PËR 6-MUJORIN E DYTË.**



**21 NËNTOR, 2023 - TAKIM ME OPERATORËT
TURISTIKË TË QYTETIT TË TIRANËS,
NË KUADËR TË PROJEKTIT
SHQIPTARO-ZVICERAN (ALSIP).**



7 DHJETOR, 2023 - WEBINAR-I RAJONAL
 MBI MBROJTJEN E MARKËS TREGTARE JASHTË VENDIT.



8 DHJETOR, 2023 - PËRFAQËSIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
 TË PRONËSISË INDUSTRIALE NË 30 VJETORIN E THEMELIMIT
 TË “ENTI SHTETËROR PËR PRONËSI INDUSTRIALE” (ESHPI), I MAQEDONISË SË VERIUT.



BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE WIPO/ EPO/ EUIPO

15-16 NËNTOR, 2023 - FORUMI VJETOR I GJYKATËSVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE TË WIPO-S.

Shqipëria përfaqësohet nga Znj.Marjana Semini, Anëtare e Gjykatës Kushtetuese përfaqësuese, e cila referoi mbi temën “Keqbesimin në rastet e shkeljes së markave tregtare”.



25 MARS, 2023 - PROGRAMI I TRAJNIMIT, MENTORIMIT DHE BASHKËPUNIMIT TË WIPO-S PËR PRONËSINË INTELEKTUALE PËR GRATË SIPËRMARRËSE

nga Komunitetet Lokale në Rajonin e Evropës Qendrore dhe të Shteteve Baltike (CEBS WEP). Shqipëria u përfaqësua me dy kandidate potenciale, znj. Flutura Xhabija dhe znj. Armida Alikaj.



6-7 SHTATOR, 2023 - Me mbështetjen e WIPO-s dhe në bashkëpunim të ngushtë me DPPI-në dhe shkollën e Magjistraturës, si dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve me përvojë në fushën e gjyqësorit për pronësinë intelektuale, zhvillohet **workshop-i me temë “On the Judicial Review of Trademark Registrability and Judgment Writing”**.



19- 20 TETOR, 2023 - 30 VJETORI I THEMELIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE - Konferencë Ndërkombëtare dy- ditore (19- 20 tetor 2023)

me temë “Women in Tradition, Innovation, Creativity and Entrepreneurship” me pjesëmarrjen e krerëve më të lartë të 3 organizatave ndërkombëtare të pronësisë intelektuale, pjesëmarrjen e zv.Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, zv. Ambasadorit të Ambasadës së Zvicrës në Tiranë, pjesëmarrjen e 12 shteteve, përfaqësuesve nga biznesi, partnerëve kombëtarë, përfaqësuesve të autorizuar etj.



MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

20 SHKURT, 2023 – nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Zyrës së Patentave të Republikës së Polonisë (UPRP).



29 MARS, 2023 – nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

24 MAJ, 2023 - Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Kolegjit Universitar Bedër.



2 QERSHOR, 2023 – Nënshkrimi i ripërtëritjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Entit Shtetëror për Pronësi Industriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



20 TETOR, 2023 – nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Agjencisë për Pronësinë Intelektuale të Republikës së Moldavisë.



18-19 DHJETOR, 2023 - Vizitë Studimore në Zyrën Greke për Pronësi Industriale (OBPI), në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit, nënshkruar midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Zyrës Greke për pronësinë industriale (OBI).



19-22 QERSHOR, 2023 - Vizitë studimore në Varshavë, Poloni, në kuadër të instrumentit të TAIEX/EC.



Vizitë zyrtare në Tiranë e homologëve të Agjencisë për Pronësi Industriale (API) të Republikës së Kosovës dhe Entit Shtetëror për Pronësi Industriale (ESHPI) të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

26 QERSHOR, 2023 - Takim për Start-up-et.

Me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Znj. Edona Bilali dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale Znj. Rovenë Beqiraj, u zhvillua një takim me start-up-et, që tashmë janë përfitues të fazës së parë të granteve të dhëna nga qeveria shqiptare.



Temat:

- Shërbimi IP- Prediagnostic Tool për Pronësinë Intelektuale i ofruar falas nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), i përkthyer dhe i përshtatur në gjuhën shqipe, i aksesueshëm nga kushdo që ka një kompjuter ose telefon celular me lidhje interneti, i cili ndihmon bizneset për të identifikuar asetet e tyre të PI-së.

Linku i IP Prediagnostic, i aksesueshëm në faqen e WIPO-s në gjuhën shqipe.

Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve

Ndërgjegjësimi me në fokus BIZNESIN

TAKIME INFORMUESE

- 24 mars, takim me bizneset në qytetin e Sarandës;
- 14-16 qershor, takim me subjektet e hoteleri-turizmit në qytetin e Korçës;
- 24-26 prill takim me subjekte e hotelerit turizmit në zonën bregdetare të Himarës dhe Dhërmiut;
- 17- 19 korrik, takim me subjektet e hoteleri turizmit në qytetin e Vlorës;
- 6-8 shtator, takim me bizneset në qytetin e Pukës;
- 20-22 shtator, takim me bizneset në qytetin e Kukësit;
- 21 nëntor, takim me subjekte dhe operatorët turistikë të qytetit të Tiranës;
- 8-10 nëntor, takim me bizneset në qytetin e Përmetit;
- 22-24 nëntor, takim me subjekte në zonën e Malësisë së Madhe;
- 29 nëntor-1 dhjetor, takim me bizneset në qytetin e Dibrës;



Ndërgjegjësimi me në Fokus EDUKIMIN

Takime me Zyrat Vendore Arsimore

- 1-3 mars, takim me Zyrën Vendore Arsimore Bulqizë;
- 5-7 prill, takim me Zyrën Vendore Arsimore Kukës;
- 12-14 prill, takim me Zyrën Vendore Arsimore Dibër;
- 19-21 prill, takim me zyrën Arsimore Pogradec;
- 26-28 qershor, takim me Zyrën Vendore Arsimore Mallakastër;
- 12-14 korrik, takim Zyrën Vendore Arsimore Maliq;



Trajnime me universitetet:

- 4 shkurt - “Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit” pranë universitetit Bujqësor të Tiranës;
- 25 prill - “Universiteti Politeknik i Tiranës”;
- 19 maj - “Instituti Kanadez i Teknologjisë”;
- 4-6 dhjetor - universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
- 18-20 dhjetor - universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;
- 20-22 dhjetor - universiteti “Eqerem Cabej”, Gjirokastër



Qendra e Trajnimeve

Qendra e Trajnimeve në fushën e pronësisë industriale, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI-së.

Qendra shërben edhe si pikë informacioni për gjithë të interesuarit në fushën e Pronësisë Industriale.

Aktivitete:

- 24-25 janar - trajnimi me temë: "Markat Tregtare, Disenjt Industrial, Treguesit Gjeografikë, Rëndësia dhe Procedura e Regjistrimit";
- 6-9 mars - pritja e ekspertit z. Andreas Kurt, udhëheqësi kryesor në përgatitjen e draftit të Strategjisë për Qendrën e Trajnimeve;
- 30-1 dhjetor - trajnimi me temë: "Markat Tregtare, Disenjt Industrial, Treguesit Gjeografikë, Patentat Për Shpikje, Rëndësia dhe Procedura e Regjistrimit".



Projekti “Train the Trainers” në fushën e Pronësisë Intelektuale.

Në kuadër të zbatimit të “Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025” Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, gjatë vitit 2023, nisi projektin pilot “Train the Trainers”, me qëllim informimin e mësuesve të sistemit të arsimit para-universitar rreth pronësisë industriale.

U zhvilluan takime në 15 (pesëmbëdhjetë) ZVA të vendit, më konkretisht në: Bulqizë, Pogradec, Kukës, Berat, Sarandë, Dibër, Maliq, Durrës, Mallakastër, Krujë, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë.

Për të gjithë mësuesit pjesëmarrës në trajnime, u shpërndanë certifikata pjesëmarrjeje, u vendosën në dispozicion materiale, botime të ndryshme dhe u prezantuar faqja e web-it : <https://www.shkollatpi.dpqi.gov.al>, dedikuar arsimit parauniversitar.



Seminar: “IP Impact Certificate Course” (IPCC)

Trajnimit i mësuesve të sistemit parauniversitar “IP4Youth&Teachers National Seminar: IP Impact Certificate Course (IPCC)”, aktivitet i mbështetur nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale dhe Zyra Koreane e Pronësisë Intelektuale në bashkëpunim me DPPI-në.



INICIATIVA LIGJORE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE

SEKTORI JURIDIK

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale, është një ndër aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale.

Objektivat e sektorit juridik janë:

- Të garantojë, që praktikat e punës së sektorëve të tjerë të drejtorisë të jenë në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi “Për Pronësinë Industriale”, aktet nënligjore dalë në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale;
- të përgatisë praktikat për miratimin ose ndryshimet në aktet ligjore, nënligjore ose aktet e brendshme të Drejtorisë, të cilat rregullojnë veprimtarinë funksionale të kësaj të fundit;
- të ndjekë të gjitha çështjet në gjykatë, ku DPPI-ja është e paditur apo merr pjesë si person i tretë;
- të marrë pjesë në Bordin e Apelimit, i cili aktualisht përgatit edhe vendimet e BA-së;
- të ndjekë procedurat e prokurimeve me vlera të vogla, marrëveshjet kuadër, etj.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore, me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE-së, është në fokusin e veprimtarisë së DPPI-së.

Për këtë, janë hartuar dhe përcjellë për miratim 2 projektligje, si më poshtë:

- a) “Projektligji për Patentat, Modelet e Përdorimit” me gjithë dokumentacionin shoqërues;

- Raporti RIA (shqip);
- Relacion Shoqërues;
- Tabela e përputhshmërisë (shqip-anglisht);
- Versioni në gjuhën shqip dhe anglisht, i projektligjit të ri “Për Patentat dhe Modelet e Përdorimit”.
- Aktet e Bashkimit European, që janë përafruar ose duhen përafruar në lidhje me patentat.

Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues dhe referuar tabelave të përputhshmërisë të dërguara, rezulton se:

I. Shpikjet bioteknologjike (përafrim i pjesshëm), patentat Europiane (përafrim i plotë), licensat jo-vullnetare (përafrim i plotë) dhe zbatimi i të drejtave të patentave (përafrim i pjesshëm) janë përgjithësisht OK;

II. SPC-të do të përafrohen plotësisht me Rregulloret e vitit 2019 dhe 2009 të BE-së.

b) Projektligji “Për Markat tregtare dhe të Shërbimit” me gjithë dokumentacionin shoqërues.

- Raporti RIA (shqip);
- Relacion shoqërues;
- Tabela e përputhshmërisë (shqip-anglisht);
- Versioni në gjuhën shqipe dhe anglishte i projektligjit të ri “Për Markat Tregtare”.

Duke u mbështetur në eksperiencën e suksesshme të vendeve të tjera të rajonit, të cilët janë integruar tashmë në BE (si p.sh. Kroacia) dhe duke patur parasysh mënyrën e përafrimit të legjislacionit për markat tregtare si dhe objektivat tona për përafrimin e plotë të legjislacionit me atë të *acquis communautaire* të Bashkimit European, hartimi i projektligjit të ri “Për Markat Tregtare” synon përafrimin e plotë të legjislacionit vendës me:

- Rregulloren (BE) nr. 2017/1001 të Parlamentit dhe Këshillit European të datës 14 Qershor 2017, për markat tregtare Europiane;

- Direktiven (BE) nr. 2015-2436 të Parlamentit dhe Këshillit Europian të datës 16 Dhjetor 2015, për përafrimin e legjislacioneve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare.

Për të dy projektligjet, konsultimi publik është kryer përmes këtyre rrugëve:

- Regjistrin të Konsultimit Publik;
- Organizatave ndërkombëtare: ZEP, OBPI, ZBEPI;
- Organizimeve të takimeve me aktorët e fushës në lidhje me projektligjet.

Janë hartuar 2 projektligjet si më poshtë, të cilat do të dërgohen për miratim brenda vitit 2024:

- ✓ Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobit” për “Mbrojtjen e Simbolit Olimpik” së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- ✓ Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Singaporit mbi ligjin e Markave Tregtare” së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Përfaqësuesit e Sektorit Juridik, janë anëtarë të Kapitullit 7 “Për Pronësinë Intelektuale” dhe kryesojnë nëngrupin për “Pronësinë Industriale”, të cilët kanë patur rol kryesor në procesin screening, duke bërë prezantimet e tyre përpara përfaqësuesve të BE-së.

Gjithashtu, ky sektor, ka ndjekur në vazhdimësi dhe ka dhënë kontribut në hartimin e PKIE-së për pjesën e Pronësisë Industriale, si dhe ka marrë pjesë në takimet e organizuara për raportim në lidhje me këtë kapitull. Gjithashtu, ka ndjekur edhe procesin e punës së kryer prej anëtarëve të tjerë të nëngrupit. Sektori Juridik, si anëtar grupi i Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes, liria për të ofruar shërbime” ka dhënë kontributin e tij në lidhje me kapitullin.

1. Ka dhënë kontribut për hartimin e “PKIE 2022-2024”, në lidhje me aktet e parashikuara nga DPPI-ja për miratim;
2. Është dhënë mendim në lidhje me 4 akte ligjore dhe nënligjore, që janë përcjellë për mendim pranë DPPI-së.

DHOMA PËR SHFUQIZIM/ZHVLERËSIM

Pranë Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim gjatë vitit 2023, janë depozituar në total 24 kërkesa, prej të cilave, 19 kërkesa për shfuqizim marke, 2 kërkesa për zhvlerësim marke dhe 3 kërkesa, për apelimin e vendimeve të refuzimit të regjistrimit të markës. Në lidhje me këto kërkesa, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim, ka marrë 14 vendime dhe 10 kërkesa janë në proces.

- Nga 19 kërkesa për shfuqizim, dhoma ka pranuar kërkesën për 5 raste, ka refuzuar kërkesën për 6 raste, ndërsa 8 kërkesa janë në proces shqyrtimi. Nga 11 vendime të mara nga Dhoma, 6 vendime janë ankimuar në Gjykatën administrative të Shkallës së Parë, Tiranë;
- Nga kërkesa për Zhvlerësim, dhoma ka pranuar kërkesën për 1 rast dhe 1 rast është në proces. Vendimi ku është pranuar kërkesa për zhvlerësim, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë;
- Nga 3 kërkesa për apelimin e vendimeve të refuzimit të regjistrimit të markës, dhoma ka pranuar kërkesën për 1 rast, ka refuzuar kërkesën për 1 rast, ndërsa 1 kërkesë, është në proces shqyrtimi. Asnjë nga vendimet e Dhomës në rastin e apelimeve, nuk janë ankimuar në Gjykatë.

BORDI I APELIT

Në Bordin e Apelit gjatë vitit 2023, janë depozituar në total 16 kërkesa, prej të cilave:

- 3 janë kërkesa për apelimin e vendimeve të Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim;
- 11 janë kërkesa për apelimin e vendimeve të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;
- 2 janë kërkesa janë për rivendosje në afat të patentave nga Sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit.

Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur kërkesat për apelim, u është bërë njoftim që ti drejtohen gjykatës kompetente, duke qënë se Bordi i Apelit gjatë vitit 2023, ka qënë në pamundësi objektive për të shqyrtuar ankimet e mësipërme, për shkak të moskonstituimit të tij.

ÇËSHTJE NË GJYKATË

Përfaqësimi i DPPI-së në çështjet gjyqësore, me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2023, me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm, janë ndjekur 23 çështje në gjykatë. DPPI-ja përfaqësohet në gjykatë në rastet kur ankimohen vendimet e Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe Bordit të Apelit, në të cilat DPPI-ja merr pjesë në gjykim si palë e paditur dhe bën mbrojtjen e vendimeve të saj me anë të prapësimeve, shpjegimeve dhe provave që paraqet në gjykatë. Gjithashtu, DPPI-ja merr pjesë në proceset gjyqësore si person i tretë edhe në çështje me objekt zhvlerësimin, shfuqizimin e markave, konkurrencën e pandershme, etj.

Gjatë vitit 2023, DPPI-ja ka ndjekur 23 çështje në gjykatë.

- 3 çështje në gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
- 19 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë;
- 1 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Në gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka marrë pjesë në 23 çështje në total, si palë e paditur me objekt shfuqizim vendim Bordit të Apelit, vendim Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe vendim Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.

Nga totali prej 23 çështjesh gjyqësore, për 6 çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë dhe lënien në fuqi të vendimeve të Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, për 1 çështje ka vendosur pranimin e kërkesës

së padisë dhe rrëzimin e vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, 2 çështje janë pushuar me kërkesë të paditësit.

Gjykata Administrative të Apelit, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe vendimin e Bordit të Apelit.

13 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, janë ende në proces shqyrtimi.

Për vitin 2023, janë parashikuar 21 procedura prokurimi në regjistrin e parashikimeve.

Deri në fund të vitit 2023, janë realizuar në total 19 procedura prokurimi si më poshtë:

- 7 procedura me vlerë nën 100 000 lekë;
- 3 procedura me vlerë të madhe "E hapur të thjeshtuar";
- 8 procedura me vlerë të vogël;
- 1 procedurë me sistem dinamik për blerje biletash.

FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE

Burimet Njerëzore janë përgjegjëse për rekrutimin, përzgjedhjen, trajnimin, zhvillimin, vlerësimin si dhe shpërblimin e punonjësve.

Menaxhimi i burimeve njerëzore, është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Një nga objektivat tona kryesore është zhvillimi i kapitalit njerëzor, pasi besojmë fort se stafi ynë, është kapitali më i rëndësishëm dhe një burim strategjik i institucionit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, janë rekrutuar pranë DPPI-së në total 9 punonjës me kontratë me kohë të pjesshme, 1 punonjës nëpërmjet DAP-it.

TË ARDHURAT

Aktiviteti i DPPI-së është përqendruar, jo vetëm në zbatimin e funksionit të saj për regjistrimin dhe administrimin e objekteve të pronësisë industriale, por edhe në forcimin e rolit të saj si institucioni përgjegjës për të nxitur individët dhe shoqëritë tregtare, që të regjistrojnë pronën e tyre industriale, si një investim i cili i shërben të ardhmes së biznesit.

Të ardhurat e DPPI-së përbëhen nga:



- Aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare;
- Të trashëguara investime, projekte në vazhdim;
- Të ardhurat nga mbrojtja e markave nga Marrëveshja e Madridit dhe Protokolli i saj për regjistrimin ndërkombëtar të markave;
- Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove;
- Të ardhura nga ZEP, për regjistrimin ndërkombëtar të patentave.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të ardhurat sipas zërave të buxhetit, dhe realizimi në përqindje, duke krahasuar vlerat e planifikuara me ato faktike për periudhën janar - dhjetor 2023.

Në 000 lekë			
ZËRAT	PLAN viti 2023	FAKT viti 2023 Realizimi	Në %
TE ARDHURAT			
Aktiviteti kryesor, aplikime kombetare	135,000	181,187	134%
Marrëveshja e Madridit	66,000	68,461	104%
Marrëveshja e Hages	1,000	1,677	168%
Të ardhura nga ZEP	100	151	151%
Totali i të ardhurave	202,100	251,476	124%

Bazuar në tabelën e të ardhurave të DPPI-së vërehet, se të ardhurat totale në vitin 2023 janë arkëtuar në masën 124%, në shumën 251 milion lekë.

Paraqitja grafike jepet si më poshtë:




ZËRAT	PLAN viti 2022	PLAN viti 2023	FAKT viti 2022 Realizimi	FAKT viti 2023 Realizimi	Fonde të disponueshme 2022	Fonde të disponueshme 2023
TË ARDHURAT						
Aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare	135,000	135,000	179,976	181,187	44,976	46,187

Siç vihet re, viti 2023 ka rezultuar me tejkalim në zërin e të ardhurave të parashikuara në fillim të vitit buxhetor. Ecuria e të ardhurave për DPPI-në, paraqitet me një realizim në masën e 181 milion lekëve ose 134% nga plani buxhetor vjetor, të të ardhurave për periudhën janar - dhjetor 2023.

Të ardhurat e aktivitetit kombëtar sipas burimit të gjenerimit

Nr.	Përshkrimi	Të ardhura nga aktiviteti kombëtar	Pesha ndaj totalit
1	Të ardhura nga Patentat	149,388	82.45%
2	Të ardhura nga Markat	30,423	16.79%
3	Të ardhura nga Modelet e Përdorimit	59	0.03%
4	Të ardhura nga Disenjt Industrialë	908	0.50%
5	Të ardhura nga Treguesit Gjeografikë & Emertime të Origjinës	10	0.01%
6	Të ardhura nga Përfaqësuesit e Autorizuar	388	0.21%
7	Të tjera të ardhura jo-tatimore	5	0.003%
8	Të ardhura nga interesat e depozitave	6	0.004%
TOTALI		181,187	100%

Të ardhurat nga aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare për periudhën janar-dhjetor 2023 janë 181 milion lekë, nga 179 milion lekë të një viti më parë, duke pësuar rritje në masën 0.67% ose 1.2 milion lekë më tepër.



SHPENZIMET

Për të mbështetur volumin e punës, plani buxhetor i vitit 2023 në krahasim me planin buxhetor të vitit 2022, (ku përfshihen shpenzimet e personelit, operative, korrente, transferta dhe kapitale) është 39.4% më i lartë. Ecuria e shpenzimeve për DPPI-në për vitin 2023 paraqitet e kënaqshme, me nje realizim në masën 262 milion lekë ose 89% të planit buxhetor vjetor të shpenzimeve, për periudhën janar - dhjetor 2023.



Më poshtë paraqitet realizimi i shpenzimeve të DPPI-së për vitet 2022 dhe 2023.

Realizimi i Shpenzimeve 2022-2023

Në 000 lekë

Emërtimi	Viti 2022			Viti 2023			
	Plani Buxhetor	Fakti / Janar Dhjetor	Në %	Plani Buxhetor	Fakti Janar Dhjetor	/ -	Në %
Shpenzime personeli	37,300	37,186	100%	55,871	46,482		83%
Shpenzime Operative	20,740	19,214	93%	25,716	14,998		58%

dhe korrente						
Transferta Korrente dhe me jashte	20,000	20,000	100%	90,000	83,095	92%
Shpenzime kapitale	105,100	12,237	12%	123,332	117,128	95%
Totali i Shpenzimeve	211,450	93,487	44,2%	294,869	261,702	89%



PROCESI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Anëtarësimi në Bashkimin Europian është prioritet strategjik i Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare hyri në fuqi më datë 1 prill 2009.

Më datë 28 prill 2009, Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Europian. Këshilli i Bashkimit Europian, vendosi që t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat në qershor 2014 dhe, në mars 2020, vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimit. Vendimi i Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit, ishte një rrjedhojë logjike e arritjeve të Shqipërisë në reformat e saj të thella, veçanërisht në lidhje me reformën në drejtësi.

Ky vendim shërbeu për t'i dhënë një shtysë të mëtejshme procesit të reformave të nevojshme, për ta përgatitur Shqipërinë për nisjen më pas të negociatave të anëtarësimit.

Aktualisht, Shqipëria i ka përmbushur të gjitha kushtet për zhvillimin e konferencës së parë ndërqeveritare dhe, jo vetëm ka ngritur kuadrin e plotë institucional për negociatat e anëtarësimit, por është duke i përgatitur këto struktura për procesin e negociatave të anëtarësimit”.

Komisioni Europian në Kapitullin 7, të raportit të vitit 2022 për Republikën e Shqipërisë është shprehur se:

Shqipëria ka një farë niveli përgatitjeje/është e përgatitur në mënyrë të moderuar për të drejtat e pronësisë intelektuale. Progres i mirë u bë gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht me miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022 - 2025” dhe harmonizimin legjislativ me acquis të BE-së, në fushat e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera në lidhje me to, si dhe të drejtave për pronën industriale.

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian është në vetvete një proces gjithëpërfshirës. Anëtarësimi kërkon reforma të thella dhe të gjithanshme, që prekin të gjithë sektorët e qeverisjes, duke synuar transformimin e plotë të kuadrit ligjor dhe institucional, ekonomisë dhe të të bërit biznes.

Veçoritë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, përcaktojnë edhe rolin dhe mënyrën se si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) ushtron detyrat e saj.

Në këtë kuadër, më datë 19-20 janar 2023, pas dy takimesh paraprake *screening* (shkurt 2019 dhe tetor 2022), u zhvillua në Bruksel takimi bilateral midis Shqipërisë dhe BE-së për kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”. Palët shqyrtuan kuadrin ligjor shqiptar për të gjitha çështjet e PI-së, që nga pronësia industriale deri tek e drejta e autorit, si dhe nivelin e zbatimit.



STRATEGJIA E RE KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në rolin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.118, datë 23.9.2020, si dhe me mbështjetjen e institucioneve të përfshira në këtë proces, ka monitoruar Strategjinë e re Kombëtare të PI-së për vitin 2023.

Konkretisht, DPPI-ja, në rolin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës ka organizuar me këtë Grup, dy mbledhje raportuese, për të diskutuar rreth arritjes së objektivave të caktuara më herët në Strategji, si dhe ka hartuar raportin monitorues për të dyja periudhat e monitorimit.

Gjithashtu, DPPI-ja ka realizuar të gjitha detyrimet, të cilat rrjedhin nga Strategjia për periudhën raportuese.

Strategjia e Re Kombëtare e Pronësisë Intellektuale 2022-2025, u hartua me kontributin e ekspertëve të grupit ndërinstitucional të punës, të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.118, datë 23.09.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intellektuale 2021-2025” si dhe me asistencën teknike të ofruar nga ekspertët e Organizatës Botërore për Pronësinë Intellektuale (OBPI) si një nga partnerët tanë më të rëndësishëm, në rrugëtimin e institucioneve për një sistem të qëndrueshëm të pronësisë intelektuale.

Mirënjohje

Ky raport u hartua falë punës dhe përkushtimit të punonjësve të DPPI-së.

Kontakte: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark”, prona nr. 33, ish Shtëpia e Ushtarakëve,
Tiranë, Shqipëri.

Website: www.dppi.gov.al

e-mail: info@dppi.gov.al

Facebook: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Instagram: Dppi Albania

Linkedin: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale